

STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së, dhjetor 2015, Nr.5, Viti IV

**Fakulteti i
Komunikimit Masiv,
fakulteti me më së
shumti konferenca
shkencore**



faqe 8



**U mbajt konferenca
shkencore
"Funksionimi i
shtetit juridik në
Evropën Juglindore"**

faqe 5

**AAB dhe Telekom
i Kosovës me
marrëveshje të re
bashkëpunimi**



faqe 2



**AAB e filloi vitin akademik
2015/16, me objektin më
modern universitar në Evropë**

faqe 2



**Tafa: Kur flitet për sukseset
e AAB-së, mendohet në
sukseset e sektorit të
Arsimit të Lartë në Kosovë**

faqe 7



**Tre studentë të AAB-së,
semestrin veror 2015/16
do ta vijnë në Poloni,
falë projektit Erasmus +
Mobility**

faqe 3

AAB e filloi vitin akademik 2015/16, me objektin më modern universitar në Evropë

Ministri Bajrami: “AAB është një institucion i cili paraqet një konkurrencë dinjitoze të arsimit publik!”



Në kampusin e Kolegjit AAB në Prishtinë u përurua objekti i ri universitar- i shtati me radhë i këtij institucioni, njëherësh objekti më modern universitar jo vetëm në Kosovë, por mbase në rajon, me një sipërfaqe prej 15 mijë metrash katrorë, ku shiritin inaugurues, para shumë të pranishmëve e kanë prerë, rektori i Kolegjit AAB prof. dr. Lulzim Tafa, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prof. dr. Arsim Bajrami dhe studentja e AAB-së, kampione botërore xhudistja Majlinda Kelmendi.

Rektori i AAB-së, prof. dr. Lulzim Tafa, duke folur para të pranishmëve, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, profesorë dhe studentë të AAB-së, dhe të ftuar të tjerë tha se ky objekt u dedikohet studentëve, stafit, si dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

“Këtë objekt me mbi 15 mijë metra katrorë, që brenda kampusit tonë do të njihet si AAB-7, ne si AAB po ia shtojmë gjashtë ndërtesave të tjera, të gjitha të ndërtuara me destinim të vetëm ak-

tivitetin arsimor për nevojat e studentëve të shumtë që ka ky institucion”, tha Tafa. Rektori Tafa, shtoi se përveç 40 sallave të mësimi, laboratorëve, ambienteve relaksuese, palestrës sportive, ky objekt do të shndërrohet edhe në qendrën kryesore kulturore të vendit me teatrin profesionist më të madhin në Kosovë me 350 ulëse, kinemanë, galerinë dhe objektet e tjera përcjellëse. “Ne si AAB mbështesim dhe përkrahim pa rezervë punën e Ministrisë së Arsimit dhe ministrit Bajrami në këtë plan, dhe sidomos përkushtimin e Ministrit për barazi të plotë mes sektorit publik e privat të arsimit, sepse këta sektorë dallojnë për nga themeluesi, por nuk dallojnë kurrë nga misioni i tyre - që është edukimi dhe arsimimi i studentëve”, tha rektori Tafa.

Ndërkaq, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prof. dr. Arsim Bajrami ka thënë se nuk ka ngjarje më të rëndësishme për arsimin e lartë sesa të prezantosh në promovimin e një objekti imponant, një objekt që plotëson të gjitha standardet evropiane që do

të mundësojë një arsimim cilësor.

“Të gjithë ju miqtë e AAB-së, duhet të ndiheni krenar që sot po marrim pjesë në promovimin e kësaj godine, e cila do t’i mundësojë studentëve tanë një mësimnxënie cilësore, një mësimnxënie të avansuar, një mësimnxënie të shekullit XXI. Ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur si Qeveri që në Republikën e Kosovës, po promovojmë standarde të tilla të objekteve moderne”, tha ministri Bajrami.

Ai tha se se Kolegji AAB është një kolegji prestigjioz që ka ndërtuar arsimin e lartë privat në Kosovë.

“Një institucion i cili paraqet një konkurrencë dinjitoze të arsimit publik. Qeveria e Kosovës do të zhvillojë politikën e barazisë së plotë të sektorit publik dhe sektorit privat dhe ne e vlerësojmë rritjen e këtij institucioni, si një instrument i rëndësishëm i ngritjes së cilësisë në universitetet tona publike. Jemi të sigurt se gjeneratat që ka dhënë AAB, kanë transformuar mentalitetin e qeverisjes në Republikën e Kosovës dhe jemi të sigurtë që standardet e cilësisë që

ka ndërtuar ky institucion janë modele që duhet të pretendohen në Republikën e Kosovës, sepse ne kemi nevojë për universitet të forta, për kolegje të forta, kemi nevojë të ndërtojmë standarde të larta të mësimdhënies dhe të cilësisë dhe ky objekt imponant që sot po promovohet, ofron të gjitha kushtet moderne për studentët, për profesorët, për një mësimdhënie interaktive, për një mësimdhënie moderne dhe të gjithë ndihemi krenarë me këtë mundësi”, tha ministri Bajrami.

“Edhe njëherë të gjithë juve studentë, të gjithë mësimdhënësve dhe juve Rektor, urime dhe shumë suksese!”

Me rastin e këtij solemniteti për realizimin e këtij projekti madhor u falënderua projektuesi dhe arkitekti Driton Tefiku dhe mbikëqyrësi Driton Ibrahim, po ashtu dhe

të gjithë punëkryesit e të gjitha kompanive vendore, të cilat i përfunduan punimet në afat rekord.

Driton Tefiku, arkitekti i objektit, ka thënë se “Madhështia e objektit është se ky mund të krahasohet me kriteret, kushtet dhe hapësirat menaxhuese të universiteteve të njohura botërore, çka do të thotë se objekti i ri ofron komoditet të lartë”. Objekti i ri i AAB-së, është një kryevepër e inxhinierisë moderne, si për nga aspekti vizual ashtu edhe për nga investimi në materialin ndërtimor. Kjo ndërtesë e re e kampusit të Prishtinës, paraqet një realizim ndërtimor me stil dhe dizajn unik e të avancuar.

Ceremonia është përcjellë me një program artistik, ndërsa madhështinë ia kanë shtuar edhe mysafirët e tjerë të shumtë.



Impresum

STUDENTI

Gazetë e studentëve të AAB-së

Botues: BPrAL AAB

Kryeredaktor: Zija Rexhepi

Redaktore përgjegjëse: Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e AAB-së

Foto:

Rrahman Drenica dhe Ylli Selmani

Dizajni grafik:

Besfort Mehmeti

e-mail: info@aab-edu.net

Tre studentë të AAB-së, semestrin veror 2015/16 do ta vijnë në Poloni, falë projektit Erasmus + Mobility



Donika Blaku, Besart Vishe-sella dhe Blina Zhubi, të cilët janë duke i vijuar studimet në Kolegjin AAB, për këtë vit të ri akademik, me bursë të plotë do t'i vazhdojnë studimet universitare për semestrin veror 2015/16, në Universitetin e Lodz në Poloni.

Me një fjalë nga ky vit i ri akademik Kolegji AAB është përfitues i projektit "Erasmus+ International Credit Mobility", projekt që financohet nga fondet e programit Erasmus për institucionet arsimore të Republikës së Polonisë.

Ky mobilitet për vazhdimin e studimeve në universitetin në fjalë është arritur në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndëruniversitar AAB dhe Universiteti i Lodz, në kuadër të implementimit të projektit të fituar për fonde të Komisionit Evropian "Credit mobility" në fushën e mobilitetit të personelit dhe të

studentëve.

Marrëveshja në fjalë, përveç shkëmbimit të studentëve, parasheh edhe shkëmbimin e stafit akademik si dhe projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, seminare dhe takime të tjera për çështje akademike e shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevojat e studimeve dhe hulumtimeve shkencore, si dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dyja vendet.

Universiteti i Lodz me seli në Poloni, është universitet publik, dhe ndër universitetet më të mëdha në vend, me bashkëpunim intensiv ndërkombëtar me më se 400 partnerë në përmasa botërore, dhe është anëtar aktiv në projekte të Komisionit Evropian dhe më gjerë.



AAB dhe Telekom i Kosovës me marrëveshje të re bashkëpunimi

VALA do të krijojë mundësi për punë praktike për të gjithë studentët e AAB-së



Me qëllim të vazhdimin të bashkëpunimit ndërinstitucional, Kolegji AAB, nënshkroi edhe një marrëveshje të re bashkëpunimi, me Telekomin e Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua nga rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa, dhe drejtori menaxhues i Telekomit të Kosovës, z. Agron Mustafa. Marrëveshja parasheh mbi 23 mijë studentët e Kolegjit AAB, për tri vitet e ardhshme të mund të komunikojnë me mijëra studentë të tjerë, që tashmë janë pjesë e pakos N'Trip të operatorit publik Vala.

Rektori i Kolegjit AAB, duke i falënderuar të gjithëve pjesëmarrësit më rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje afatgjate - tre vjeçare, ndër të tjera tha: "Ne me Telekomin e Kosovës kemi pas bashkëpunim edhe në të kaluarën, por sot jemi pajtuar që këtë bashkëpunim ta zgjerojmë edhe në fusha të tjera të ndryshme. AAB me potencialet e veta, me studentët e vet, me stafin akademik dhe administrativ, do të shërbehet me shërbimet e Telekomit të Kosovës, ndërsa marrëveshja parasheh që edhe Telekom i Kosovës të përkrahë aktivitetet e ndryshme të AAB-së në fushën akademike, shkencore, artistike, sportive, etj.."

Ndërsa drejtori menaxhues i Vala-s, z. Agron Mustafa,

tha se është jashtëzakonisht i kënaqur me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, pasi që kjo marrëveshjeje për Telekomin e Kosovës, përkatësisht për Vala-n, është njëra ndër më të fuqishmet e realizuara deri tani.

"Kjo është marrëveshjeje me kolegjin më të fuqishëm në vend, dhe e cila do të nisë të realizohet nga ky vit i ri akademik", tha ai. "Me anë të kësaj marrëveshjeje i kemi precizuar disa gjëra. Në fakt, së paku 15 mijë studentë do të bëhen pjesë e komunitetit të pakos N'Trip të operatorit publik Vala", njoftoi Mustafa. Të gjithë studentët e AAB-së të cilët do të pajisjen falas me numra të rinj të VALA-s dhe do të jenë pjesë e pakos "N'Trip", e cila është lansuar para tre muajsh, dhe synimet e saja janë që pjesa më e

madhe e të rinjve në Kosovë dhe studentët të jenë pjesë e kësaj pakoje, pasi është më atraktivja dhe me cilësinë më të lartë.

AAB dhe Telekom i Kosovës, kanë bashkëpunuar edhe më herët me pikësnyim përkrahjen e ngritjes së nivelit edukativ dhe profesional të të rinjve kosovarë, si dhe në krijimin e një ambienti më të volitshëm ekonomik.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje në mes të AAB-së dhe Telekomit të Kosovës në frymën e partneritetit publiko-privat, është edhe një tregues i qartë për punën që po bëhet në AAB për ngritjen e cilësisë si në aspektin akademik e shkencor, po ashtu edhe të shërbimeve përcjellëse që ofron ky institucion i arsimit të lartë në Kosovë.



Studentët e AAB-së mbështesin fëmijët me autizëm

Në vazhdimësinë e mbështetjes së shoqatave e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, në zhvillimin dhe realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme edukative e sportive, studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të AAB-së, zhvilluan një aktivitet bashkë me fëmijët e Asociacionit Nacional të Autizmit në Kosovë.

Studentët tanë, bashkë me udhëheqësit e Asociacionit Nacional të Autizmit në Kosovë, ndihmuan fëmijët autistë të Kosovës të përvetësojnë notin, aktivitet ky që u mbajt në pishinën e shkollës "Zenit".



Prodekani Zenel Metaj, ka thënë se përmes këtij aktiviteti sportiv fëmijët fitojnë njohuri të reja teknike për sportin e notit. Po ashtu Metaj, u shpreh tejet

i kënaqur me studentët e AAB-së, të cilët, siç tha Metaj, ende pa përfunduar studimet janë të gatshëm që në mënyrë shumë profesionale dhe kujdesshëm të zhvillojnë aktivitete të tilla.

Universiteti i Sarajevës i ndan mirënjohje Kolegjit AAB

Për bashkëpunimin shkencor e hulumtues në fushën e luftimit të krimit e sigurisë, Kolegji AAB u nderua me mirënjohje nga Fakulteti i Shkencave Kriminale të Universitetit të Sarajevës. Mirënjohjen e ndau dekani i fakultetit në fjalë prof. dr. Nexhat Korajliq, dhe në emër të Kolegjit AAB e pranoi prodekani i Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, cand. dr. Fatmir Qollakaj. Kjo mirënjohje u nda në hapjen e ceremonisë solemne të konferencës shkencore ndërkom-bëtare "Kriminologjia dhe kriminologjia në funksion të sistemit të sigurisë", të organizuar në Sarajevë nga Fakulteti i Shkencave të Kriminologjikës të Universitetit të Sarajevës. Nga AAB-ja prezantoi prodekani Qollakaj, me punimin e tij shkencor: "Rëndësia e edukim-



it në fushën e kriminologjikës e kriminologjisë si faktor i suksesit në sistemin e sigurisë të Republikës së Kosovës". Po ashtu zotëri Qollakaj ka realizuar edhe një varg takimesh me menaxhermentin e lartë të këtij fakulteti, lidhur me realizimin sa më të suksesshëm të kon-

ferencës shkencore të radhës, e cila do të mbahet me 30 tetor, në hapësirat e Kolegjit AAB, të organizuar nga Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB dhe Fakultetit për Kriminologjikë, Kriminologji dhe studime të Sigurisë të Universitetit publik të Sarajevës.

U ndanë certifikata për studentët e Fakultetit Ekonomik që mbaruan punën praktike në ATK

Në një ceremoni rasti, dekani i Fakultetit Ekonomik, u ka ndarë certifikata 32 studentëve të vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB, të cilët me sukses kanë përfunduar punën praktike në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).

Gjatë kësaj ceremoni u cekë Me këtë rast u tha se puna praktike është një mundësi e shkëlqyer e cila ka ndikuar në ngritjen e dijeve për profesionin që janë

duke e studiuar. Ndërsa studentët kanë thënë se, kjo praktikë na ka mundësuar lidhjen midis njohurive teorike të fitu-

ara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike.



Diplomoi kandidatja e parë në studimet master, në Fakultetin e Shkencave Sociale



Studentja Shemsije Selimi-Beqiri, është kandidatja e parë në studime master në Fakultetin e Shkencave Sociale, në programin Politikë sociale dhe mirëqenia e fëmijëve, e cila e ka mbrojtur me sukses temën e diplomës në këtë fakultet.

Shemsije - Selimi Beqiri ka hulumtuar në temën e saj "Bashkëpunimi i institucioneve sociale dhe atyre të drejtësisë në Repub-

likën e Kosovës në luftimin dhe parandalimin e abuzimit të fëmijëve", e cila u mbrojt para komisionit në përbërje: Prof. dr. Lulzim Tafa, kryetar, prof. dr. Buniamin Memedi, mentor, dhe prof. dr. Anton Berishaj, anëtar.

Kandidatja u vlerësua shkëlqyeshëm për punën e bërë gjatë hulumtimit dhe për prezantimin e bërë para komisionit dhe të pranishmëve të tjerë.

AAB, marrëveshje bashkëpunimi me OJQ "Banimi social dhe të drejtat pronësore në Kosovë"

Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me qëllimet dhe interesat e përbashkëta, Kolegji AAB dhe OJQ "Banimi social dhe të drejtat pronësore në Kosovë", nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimi i kushteve sa më të mira për studentët e AAB-së, për të mbaruar mësimin praktik në OJQ "Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë", në sektorin e TIsë, përkthimit në gjuhë angleze dhe anasjelltas, dhe aktivitete të tjera të shumta të cilat janë në shërbim të studentëve dhe të të dyja institucioneve.

Pas nënshkrimit të mar-

rëveshjes, drejtori i OJQ-së "Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë", Agron Beka, ka thënë se ky është vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.



U mbajt konferenca shkencore “Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore”



Përfundoi punimet Konferenca shkencore ndërkombëtare nga fusha e drejtësisë “Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore”, organizuar nga Fakulteti Juridik i Kolegjit AAB, në bashkëpunim me Fakultetin për Kriminologji, Kriminologji e Studime të Sigurisë të Universitetit të Sarajevës, dhe në partneritet me Universitetin e Tiranës, Shoqatën e Juristëve të Austrisë, Akademikën Policore të Zagrebit (Kroaci), duke zgjuar interesim të jashtëzakonshëm të akademikëve, studiuesit dhe profesionistët e kësaj fushe nga shumë vende të shteteve të rajonit dhe Evropës si: Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Austria, etj.. Me rastin e hapjes së punimeve të konferencës, rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa, tha se duke e kuptuar rolin shkencës në përgjithësi, AAB si institucion i arsimit të lartë i ka kushtuar rëndësi të veçantë

ngritjes së kapaciteteve të brendshme për të avancuar këtë komponentë mjaft të rëndësishme për shoqërinë tonë. Rektori Tafa shtoi se tema e konferencës së sotme “Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore” është një temë shumë aktuale, por edhe shumë sfiduese, sidomos në shtetet e rajonit tonë me demokraci të reja e me institucione të brishta, sidomos në sferën e drejtësisë. Ndërsa, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prof. dr. Arsim Bajrami, tha se është kënaqësi që në cilësinë e ministrit të marrësh pjesë në hapjen e një konference shkencore, të një kolegjii shumë të rëndësishëm në Kosovë, i cili në vazhdimësi po investon në komponentin kërkimor shkencor, që është vendimtar për sektorin e arsimit të lartë, sepse universitetet nuk janë vetëm për mësimdhënie, por duhet të

jenë edhe institucione që stimulojnë dhe zhvillojnë kërkimin shkencor si komponent i rëndësishëm i misionit të universiteteve tona. “Kolegji AAB është lider në vendin tonë sa i përket organizimit të konferencave e debateve shkencore, dhe është një model i mirë që duhet ta ndjekin edhe universitetet publike që krahas mësimdhënies të bëhen vatra të fuqishme të kërkimit dhe hulumtimit shkencor”, tha ministri Bajrami. Prof. dr. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë, në fjalën e tij tha se pavarësisht se ne si rajon kemi specifikat tona veç e veç, kemi edhe ngjashmëri dhe synimin e përbashkët, integrimin në Bashkimin Evropian. Kuçi tha se rekomandimet e kësaj konference do t'i marrin me seriozitet dhe do t'i shqyrtojnë. “Qëllimi është që në gjithë rajonin të kemi një sistem juridik më të mirë”, theksoi ministri Kuçi.

Në hapjen solemne, ministri i Drejtësisë i Republikës së Maqedonisë prof. dr. Adnan Jashari, tha se konkluzat e kësaj konference janë të mirëseardhura edhe për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, që do të tentojnë t'i zbatojnë.

Dekani i FKKS të Universitetit të Sarajevës, prof. dr. Nedad Korajli, tha se me AAB-në kanë një bashkëpunim në të gjitha sektorët, si në shkëmbimin e stafit akademik, organizmin e konferencave, dhe sot ndihet i nderuar në cilësinë e bashkorganizatorit.

Seancën plenare e moderoi prof. dr. Elmedin Muratbegovi, ku me kumtesat tyre u paraqitën folësit kryesorë të konferencës, si prof. dr. Roland Miklau, nga Shoqata e Juristëve të Austrisë, me temën “Elementët kyç të sundimit të ligjit në Evropën Juglindore”. Prof. Miklau në fjalën e tij tha se shteti i së drejtës është për të garantuar të drejtat e njeriut në mënyrë që të shërbejë e të kultivojë demokracinë. Ai mori disa shembuj në shtetet e Bashkimit Evropian se si funksionon shteti i së drejtës dhe si janë të rregulluara

strukturat shtetërore. Kurse, prof. dr. Altin Shegani, dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, me temën “E drejta penale e rendit publik”; Josip Pavliek, PhD., nga Akademia Policore e Zagrebit në Kroaci me temën “Siguria e korporatave si pjesë e sistemit të sigurisë”; prof. dr. Nedad Korajli, nga Universiteti i Sarajevës me temën “Shqyrtimi krahasimor i analizës statistikore për refuzimin e kallëzimeve penale në Republikën e Kroacisë dhe BeH”; si dhe prof. dr. Muhamet Kelmendi, dekan i Fakultetit Juridik në AAB, me temën “Tapitë e Perandorisë Osmane – bazë e njohjes së pronësisë në Kosovë”.

Përveç seancës plenare punimet e konferencës u zhvilluan në tri sesione, ku prezantuan mbi 60 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave përkatëse, të cilët dhanë kontributin e tyre me punimet dhe gjetjet e tyre shkencore dhe me debatet e zhvilluara në kuadër të konferencës.



AAB ishte nikoqire dhe bashkorganizatore e konferencës më të madhe regjionale nga fusha e studimeve sociologjike



Një vit më parë Kolegji AAB dhe Instituti Shqiptar i Sociologjisë, kanë ftuar studiues nga e gjithë bota për të marr pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë “Emigracioni ndërkombëtar dhe ndikimi i tij në shoqërinë bashkëkohore”. Në Konferencën e mbajtur në Kolegjin AAB në Prishtinë, morën pjesë mbi 260 shkencëtar e hulumtues nga 24 vende të botës. Ky aktivitet shkencor u bë në bashkëpunim me Shoqata Sociologjike Shqiptare (SHSSH), Shoqatën Ndërkombëtare të Sociologjisë (ISA), Forumin Sociologjik të Ballkanit (BSF), Shoqatën e Sociologëve të Kosovës (SHSK), Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD), Universitetin Europian të Tiranës (UET), Universitetin “Marin Barleti”, Tiranë (UMB) dhe me përkrahjen e UNICEF-it në Kosovë. Punimet e konferencës zgjatën dy ditë, që u zhvilluan paralelisht në 15 sesione tematike, ku u trajtuan tema mbi faktorët shtytës dhe tërheqës, mbi aspektet pozitive dhe negative të shkaqeve dhe të pasojave të migracionit ndërkombëtar të vendeve të origjinës dhe të destinacionit, përkatësisht të ndikimit të migracionit ndaj institucioneve sociale - kulturës, politikës, ekonomisë, edukimit e kështu me radhë, që kanë ndikim të dominojë në zhvillimet e ardhshme.

Gjatë trajtimit të tematikave të konferencës, ndër të tjera u tha se migracioni paraqet krizën më të rëndë në të cilën sot përballët Evropa. Ndaj, kjo krizë jo vetëm që prek vlerat morale, që paraqesin themelet e BE-së, por ato reflektojnë edhe në sigurinë evropiane dhe politikat e saj. Sa për ilustrim të përmendim valën e refugjatëve që dëshmoi qartë mungesën e vizionit afatgjatë të kësaj krize. Përdallim nga të tjerët, Rustem-Buzhala, profesor në Kolegjin AAB, preku format e integritetit të shqiptarëve në Turqi, si nëpërmjet të krijimi të shoqatave shqiptaro-turke dhe ndjenjën e barazisë si formë e integritetit të shqiptarëve në Turqi. Vlenë të theksohet se rektori i Kolegjit AAB, LulzimTafa, në hapjen e kësaj konference falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhënë kësaj tematike që sot është aktualitet evropian dhe botëror. Ai ka thënë se AAB sivjet ka organizuar katër konferenca të nivelit të lartë shkencor, atë të arkitekturës, të mediave, të drejtësisë dhe tash së fundi te fusha e sociologjisë, që vet ndërlidhet edhe me 16 fushat e tjera, ku për organizimin e këtyre konferencave, ka bashkëpunuar me shumë universiteteve dhe institucioneve prestigjioze. Ai ndër të tjera veçoi edhe lëvizjeve të mëdha nga vendet aziatike të përfshira në konflikte e



luftëra të pakuptimta. Fatkeqësisht në fillim të këtij viti, edhe vendi ynë, Kosova, u përball me situata të vështira të daljes masive të popullatës së saj jashtë vendit.

Ndërkaq, ministri i Diasporës, Valon Murati, në fjalën e tij tha se tema e kësaj konference është temë e veçantë pasi që bota shqiptare ka filluar t'i trajtojë edhe në planin akademik dhe shkencorë tema të rëndësishme të tilla si ky i emigracionit, përfundoi ministri Murati.

Në anën tjetër ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, tha se emigracioni dhe emigrantët kanë qenë dhe mbeten një ndër faktorët kryesor të zhvillimit të botës sot. Çështjet që ngritën këtu duhet të jenë udhërrëfyese edhe për klasën politike të çdo vendi me demokraci të cunguar zhvillimore.

Vlenë të përmendët fakti se në ceremoninë e hapjes së kësaj konference, u ndanë edhe tri çmime, njëri për Studiuesin më të mirë në 10 vjetët e fundit, të cilin e mori studiuesi

nga Shqipëria Servet Pëllumbi, ndërsa, dy çmimet e tjera për kontributin e tyre në hulumtime shkencore e morën studiuesit Mark Tirtra dhe Ulisi Haku.

Poshtu, gjatë kësaj ceremonie u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi ndëru-niversitar mes Kolegjit AAB dhe Universitetit të Durrësit "Aleksandër Mojsiu", të cilën e nënshkruan rektorët e institucioneve përkatëse Luzim Tafa dhe Mid'hat Mema.

Marrëveshja do të përfshijë të gjitha programet e studimit të organizuara nga palët nënshkruese, duke u bazuar në principet e barazisë dhe reciprocitetit, sipas kësaj marrëveshje të të dyja institucionet do të aplikojnë bashkërisht për fonde vendore e ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë e të shkencës.

Në konferencë u prezantuan edhe një varg punimesh e hulumtimesh të studiuesve të rinj, mësimdhënës universitarë dhe të institucioneve partnere të AAB-së dhe studentë të këtyre profileve.



Fjalimi i rektorit Tafa për festat e fundvitit

Tafa: Kur flitet për sukseset e AAB-së, mendohet në sukseset e sektorit të Arsimit të Lartë në Kosovë

Rectori i Kolegjit AAB, prof. dr. Luzim Tafa, me rastin e festave të fundvitit, në veçanti falënderoi të gjithë stafin për punën e tyre të palodhshme, që e kanë bërë gjatë vitit që po e lëmë pas, pastaj për aktivitetet e shumta që janë organizuar nga AAB, duke u nisur nga ndërtimi i objektit të shtatë, këtu në Prishtinë, objekt ky më i madhi në vend dhe në rajon. Ndaj, "Lirisht mund të them se deri më sot investimi më i madh që është bërë ndonjëherë në sektorin e Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe në rajon padyshim se është bërë në Kolegjin AAB. Sot ky Kolegj ka shtatë objekte universitare, të cilat funksionojnë në Prishtinë, Gjakovë dhe në Ferizaj", ka thënë rektor Tafa, duke e përmbyll vitin kalendarik të aktiviteteve dhe të punës.

Po ashtu, rektor Tafa ka thënë se gjatë vitit që e lamë pas AAB ka organizuar katër konference shkencore në nivel ndërkombëtar si: "Arkitektura dhe Identiteti", "Informacioni global dhe kulturat kombëtare", "Funksionimi i shtetit juridik në Evropën Juglindore", dhe konferenca shkencore në temën "Emigracioni ndërkombëtar dhe ndikimi i tij në shoqërinë bashkëkohore". Këto aktivitetet shkencor u bënë në bashkëpunim me universitetet më prestigjioze të botës, ku kryesisht pjesëmarrës kanë qenë studiues dhe profesionistë të fushave përkatëse. Përveç tjerave rektor Tafa ka thënë se gjatë vitit që e lëmë, Kolegjin AAB e vizituan, por edhe mbajtën ligjërata speciale shumica e ambasadorëve të akredituar në Kosovë. Në fakt, diplomatët e huaj dhe ekspertët e shumtë, trajtuan tema nga më të ndryshmet me studentët e AAB-së, nëpërmjet të cilave Qeverisë së Kosovës, por dhe botës i dërguan shumë mesazhe për Kosovën. Më mesin e shumtë të diplomatëve por edhe të ekspertëve të huaj, ishte ambasadorja e Gjermanisë, z. Angelika Viets, pastaj shefja e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë, ambasadorja, z. Konstantina Athanassiadou, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar (Anglisë), z. Ian Cliff, diplomati



amerikan, z. Scott Lang, ambasadori norvegjez, z. Jan Braathu, ambasadori i Malit të Zi, z. Radovan Miljanij, ambasadori i Hungarisë, z. László Márkus, etj.

Me këtë rast rektor Tafa nuk ka lënë pa i përmendur edhe disa trajnime e ligjërata të mbajtura nga profesorët dhe ekspertët ndërkombëtar si: profesoresha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dr. Marry Ellen, profesoresha e njohur nga Universiteti Shtetëror i Kalifornisë, Ann Snow, phd. Andrea Grilletto, pastaj ish-drejtori i Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG) në Bruksel, z. Marc Gruber, ministri i Shqipërisë, z. Erion Veliaj, prof. Tomasz Kamusella, nga Skocia, nga arkitekti zviceran Michael Mayer. Kurse çmime janë ndarë për Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, z. Robert Bosch, që u laureua me Çmimin "Doctor Honoris Causa", si dhe shkrimtarin nga Mali i Zi, z. Jevrem Bërković, me Çmimin "Ali Podrimja", etj. Po ashtu shumë student të AAB-së për t'i vazhduar studimet për master u pranuan në universitetet më prestigjioze në rajon, Evropë dhe botë. Rektor Tafa ka shtuar se nga viti ky vit i ri akademik - 2015/2016, por dhe për disa vite me radhë Kolegji AAB është përfitues i projektit "Erasmus+International Credit Mobility", me të cilin janë një varg marrëveshjesh për bashkëpunim në nivelin ndërkombëtar. Po ashtu, ky institucion me shtëpinë e vete botuese ka publikuar një varg botimesh

shkencore, e ndër to edhe dy numra të revistës shkencore me karakter ndërkombëtar "THE-SIS". Njëherësh, ka botuar edhe libra të fushës akademike, të cilat mbështesin drejtpërdrejt plan-programet e Kolegjit AAB, por ka publikuar edhe tituj të librave nga fusha e letërsisë dhe të publicistikës, etj., si dhe biblioteka e AAB-së është pajisë me numër të madh të titujve më të ri shkencor. Po ashtu me qëllim që t'u ofrojmë studentëve dhe pjesëmarrësve të tjerë një program shumë prestigjioz, me organizime të veçanta, si ligjërata të shumta speciale, debate e tryeza, konferenca shkencore, si dhe aktivitete kulturore-artistike, sportive e humanitare, kemi organizuar manifestimin më të madh universitar në Kosovë, "Ditët e AAB-së 2015". Më pastaj, mund të thuhet se si "Si çdo vit tjetër, AAB-ja është institucioni për të cilën të rinjtë nga e gjithë Kosova dhe më gjerë kanë shfaqur interesimin për të studiuar, d.m.th. për vitin e ri akademik kemi pas interesim kulmues nga kandidatët e rinj. Me një fjalë, kur flitet për sukseset e AAB-së, flitet për sukseset e sektorit të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës". Mesazhi i rektorit Tafa me rastin e Vitit të Ri 2016:

"Të gjithë studentëve të AAB, stafit akademik dhe administrativ, si dhe gjithë partnerëve, dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës ju uroj festat e fundvitit dhe u dëshiroj suksese në vitin 2016".

Fakulteti i Komunikimit Masiv, fakulteti me më së shumti konferenca shkencore

Vetëm Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së ka realizuar pesë konferenca shkencore për mediat dhe komunikimet në tre vitet e fundit, duke u bërë kështu fakulteti me më shumë konferenca shkencore madje edhe se disa universitete bashkë.



Fakulteti i Komunikimit Masiv – Gazetarisë i Kolegjit AAB, realizoi fundjavën e kaluar konferencën e pestë shkencore ndërkombëtare. Krahas studiuesve të medieve dhe komunikimeve nga Italia dhe Shqipëria, në këtë konferencë të organizuar nga Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Firences dhe Fakulteti i Komunikimit Masiv-AAB, morën pjesë 7 profesorë nga AAB-ja si institucion bashkorganizator i kësaj konference, me temë “Letërsia dhe Media-një perspektivë krahasuese”.

Kjo është konferenca e pestë me radhë që Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së ka qenë organizator ose bashkorganizator i konferencave shkencore, duke u bërë kështu institucioni i vetëm në Kosovë që vetëm brenda një periudhë trevjeçare ka organizuar kaq shumë kon-

ferenca të profilizuara shkencore.

Muaj më parë, Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së organizoi në ambientet e veta konferencën shkencore ndërkombëtare për mediat dhe komunikimet së bashku me Ecole Supérieure de Journalisme të Parisit e cila është shkolla më e vjetër e gazetarisë në botë; me IPAG School të Parisit dhe me Departamentin e Komunikimit dhe Gazetarisë të Universitetit publik të Tiranës. Në këtë konferencë të titulluar “Informacioni masiv global dhe kulturat kombëtare” u prezantuan 51 kumtesa nga studiuesit e mediave dhe komunikimeve nga Franca, Shqipëria, Kosova, Rumania, Mali i Zi dhe Maqedonia.

Një konferencë tjetër e rëndësishme u mbajt më 24 dhjetor 2013 në Tiranë me temë: “Me-

diologjia si pjesë e edukimit qytetar të rinisë shkollore dhe vendi i saj në kurrikulat e arsimit të mesëm”. Konferenca ishte e organizuar nga Departamenti i Komunikimit dhe Gazetarisë i Universitetit të Tiranës dhe nga Fakulteti i Komunikimit Masiv i Universitetit AAB, duke dalë edhe me një botim voluminoz që u sugjerohej qeverive në Tiranë dhe Prishtinë rishikimi i planeve mësimore që kanë të bëjnë me edukimin mediatik.

Në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, më 15 nëntor të vitit 2012, Departamenti i Komunikimeve dhe Gazetarisë i Universiteti publik të Tiranës dhe Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së mbajtën konferencën më të madhe shkencore me temë “Historia e medias dhe mediatizimi i historisë”. Për shkak të vitit jubilar dhe temës që trajtonte konferenca, ajo zhvilloi punimet në mjesdiset e Kuvendit të Shqipërisë nën përkujdesjen e kryetares së atëhershme të Kuvendit, Jozefina Topalli.

Po në vitin 2012, Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së ishte bashkorganizator i një konference shkencore për mediat dhe komunikimet, që titullohej “Televizioni përballë audiencave”. Konferenca u mbajt më 10 maj në Tiranë, organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës dhe nga Fakulteti i Komunikimit Masiv i AAB-së.

Studentët e degës së Ferizajt, fitues të garës së dijes për “Mikroekonomi” të organizuar në Kolegjin AAB

Fakultetit Ekonomik i Kolegjit AAB, nën udhëheqjen e stafit akademik, për studentët e vitit të parë organizoi garat e dijes nga lënda “Mikroekonomia”, për vitin akademik 2015/2016. Në këto gara morën pjesë gjithsej 32 studentë, që janë përgjigjur në mbi 60 pyetje, të ndarë në pesë grupe; tri grupe nga Kampusi i Prishtinës, një grup nga Kampusi i Gjakovës dhe një grup nga Kampusi i Ferizajt, i cili grup me pakë pikë në epërsi ndaj grupeve të tjera doli fitues i kësaj gare, me 85 pikë.

Të gjithë studentët pjesëmarrës në garat në fjalë janë shpërblyer me nga një certifikatë, ndërsa grupi fitues, është shpërblyer edhe me librin “Hyrje në Ekonomi”, i autorëve Ahmet Mancellari, Sulo Haderi, Dhori Kule dhe Stefan Qirici.

Në këtë aktivitet përveç stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti i pranishëm ishte edhe rektori i Kolegjit AAB, prof. dr. Lulzim Tafa, i cili u nda tejet i kënaqur me përgjigjet, shkathtësitë dhe njohuritë e studentëve: “Me anë të këtyre aktiviteteve dëshirojmë që ta tërheqim vëmendjen dhe kureshtjen e studentëve ndaj shkencës”, ka thënë rektori Tafa. Ndërsa, përgjegjësi për aktivitete studentore, Donat Rexha ka thënë se krahas aktiviteteve tjera në këtë semestër e kanë paraparë edhe këtë aktivitet, ku qëllimi i kësaj gare ka qenë që studentët e të tria degëve kampuseve të shkëmbejnë përvoja dhe të njoftohen ndërmjet veti përmes aktiviteteve, të cilat kryesisht kanë karakter shkencorë.



Studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale vizituan Qendrën e Fëmijëve “Dielli” në Drenas

Me rastin e festave të fundvitit, Fakulteti i Shkencave Sociale të Kolegjit AAB, në bashkëpunim me një grup të studentëve të drejtimi Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve të këtij institucioni, të shoqëruara nga mësimdhënësja Alberita Bytyqi, vizituan Qendrën e Fëmijëve “Dielli”, në kuadër të shkollës “Rasim Kijina”, në Drenas. Përveç vizitës studentët e AAB-

së shfaqën edhe një program me karakter edukativ- recituan poezi dhe bashkë më fëmijët pikturuan edhe dy punime. Fëmijët dhe edukatorët e qendrës “Dielli” u ndanë të kënaqur nga ky organizim i studenteve të AAB – së. Në fund të këtij aktivitetit, studentet e AAB-së i shpërblyen fëmijët me nga një fletore të Kolegjit AAB.



Afaristi Ramiz Kelmendi:

“Për të qenë të suksesshëm si afaristë duhet të keni ide dhe projekte tuajat origjinale”

Në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, Oda Ekonomike Amerikane, në bashkëpunim me Kolegjin AAB organizuan eventin “SpeakerSeries” (cikël ligjëratah), ku para studentëve të Fakultetit Ekonomik do të flasin ndërmarrë të suksesshëm nga vendi, rajoni dhe më gjerë.

Në takimin e parë të këtij cikli, para studentëve të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit AAB foli biznesmeni më i suksesshëm kosovar, Ramiz Kelmendi, nga kompania ELKOS Group. Ai foli për rrugëtimin e tij në biznes, themelimin dhe zhvillimin e kompanisë “ELKOS Group”. Ai u ndal te sfidat nëpër të cilat ka kaluar, deri në zhvillimin e kompanisë së tij “ELKOS Group” në nivelin që është sot, po ashtu edhe për funksionimin si dhe planin biznesor për

pesë vitet e ardhshme.

z. Kelmendi u sugjeroi studentëve që të kenë ide dhe projekte origjinale, sepse, sipas tij, në këtë mënyrë mund të jenë afaristë të suksesshëm në të ardhmen, duke potencuar se edhe teknologjia po ndikon në uljen e nevojave për fuqi punëtore, por që duhet të jenë në hap me kohën. “Kosova ka rreth 320 mijë të punësuar që janë të regjistruar, por ka 1.1 milion të aftë për punë. 82 mijë që janë të punësuar në sektorin publik, mund t’i zëvendësojë dikush vetëm nëse dalin në pension. Shumica e institucioneve financiare po e zvogëlojnë stafin për arsye se po e integrojnë teknologjinë në funksion. Andaj ju duhet të jeni në hap me kohën dhe të keni ide tuajat”, vlerësoi Kelmendi.

Kelmendi në këtë ligjëratë mori



edhe disa shembuj se si disa nga ekonomitë, për shkak të trendit të kohës, nga shumë të suksesshme tani nuk ekzistojnë

fare. Ai u dha edhe disa sugjerime studentëve se si mund të jenë të suksesshëm si afaristë të ardhshëm. Në fund të kësaj

ligjërate pati edhe një debat, ku pyetjeve të studentëve iu përgjigj biznesmeni Ramiz Kelmendi.

Barazia në mes të dy gjinive – vlerë më themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë



Në kuadër të realizimit të projektit “A jam e barabartë në shoqërinë kosovare”, përkatësisht të “16 ditë aktivizim, stop dhunës ndaj gruas”, të përkra-

hur nga UNDEF, në Kolegjin AAB u mbajt diskutimi mbi barazinë gjinore në shoqërinë kosovare. Me theks të veçantë u diskutua roli dhe fuqizimi i

gruas në shoqërinë kosovare, problematikat dhe shqetësimet që mbart pozicioni i saj, si dhe fuqizimi i saj në vendimmarrje si në vendet tjera demokratike dhe me ekonomi të zhvilluar. Në këtë aktivitet morën pjesë: Alma Lama, deputete e LDK-së në Kuvendin e Kosovës, Jeta Xharra, drejtoreshë e BIRN Kosova, Lule Demolli, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, dhe Basri Kastrati, udhëheqës i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

Me këtë rast deputetja Alma Lama, në diskutimin e saj ka thënë se është përkrahëse e madhe e kuotës në Parlamentin e Kosovës, sepse kjo kuotë rregullon padrejtësitë e kamotshme ndërmjet dy gjinive. Gjendjen e ilustroi me shembuj nga Parlamenti Evropian, që sipas Lamës, futja e kuotave implikon jo vetëm aspektin e përfaqësimit, por ndikon edhe në shumë aspekte të tjera, si zbatohen ato norma në institucione, në shoqëri në përgjithësi dhe atë në etapa të ndryshme. “Dikush thjesht mund të mendojë se gratë janë dekor në Parlamentin e Kosovës, gjë që nuk pajtohem, sepse janë shumë të zëshme. Bile, në fushatën e fundit, kudo që kam shkuar, të

gjithë votuesit që i kam takuar, më kanë thënë se do t’i votojnë gratë, çka do të thotë se votuesit kanë besim te gratë. Në partinë time, në LDK, gratë janë votuar shumë më shumë”, ka thënë deputetja Lama.

Ndërkaq, Basri Kastrati, përveç që foli për historinë e Zyrës që drejton, ai tha se kjo zyre ka për detyrë t’i mbrojtë interesat e viktimave në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë. Po ashtu, Kastrati tha se statistikat që kanë kërkuar ndihmë në këtë qendër, flasin se në vitet e fundit është shënuar rritje në vetëdijesimin e gruas në shoqërinë kosovare. Një gjë e tillë është arritur falë infrastrukturës ligjore në Kosovë, e cila padyshim se është më e mira në rajon sa i përket mbrojtjes së të drejtave të gruas, por që ende zbatimi i tij lë për t’u dëshiruar, përfundoi Kastrati.

“Puna dhe pavarësi ekonomik janë mjet mbrojtës ndaj dhunës së grave”, ka thënë Jeta Xharra, dhe shtoi se pavarësi ekonomik i gruas është një ndër shkaqet kryesore pse ajo e duron dhunën në familje dhe lejon t’i bëhen shumë të padrejta. Ajo përmendi edhe disa statistika, ku një ndër to ishte çështja e trashëgimisë së pronës famil-

jare ku më shumë se 90% të femrave deklarojnë se pjesën e saj ua lënë vëllezërve.

Ndërkaq, Lule Demolli shtoi se pozita në të cilën është sot grua, është shumë e vështirë, sidomos në sektorin e punësimit. Në fund të debatit u tha se barazia në mes të dy gjinive është vlerë më themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Në fund të këtij debati studentët e AAB parashtruan pyetje duke cituar raste të viktimave të fundit në Kosovë, të cilat raste kanë tronditur edhe vendet demokratike.



Prof. Tomasz Kamusella: Në Kosovë të krijohet ambient i përshtatshëm për diversitet

Profesori nga Skocia, prof. dr. Tomasz Kamusella para studentëve të Kolegjit AAB, mbajti një ligjëratë në temën “Martesa e vështirë - diversiteti dhe demokracia në Evropën Qendrore pas vitit 1989”. Për këtë temë ai solli shumë shembuj të natyrës së ndryshimeve që kanë ndodhur në Evropën Qendrore ndër vite duket se mund të ndodhin edhe në Kosovë. Ndaj, qytetarët e Kosovës duhet të krijojnë ambient sa më të përshtatshëm për jetesë pa problem dhe me diversitet, për të gjitha etnitetet. Sipas profesorit Kamusella, martesat mes demokracisë dhe diversitetit është elementi

më i komplikuarat në botë në shekullin e XXI-të, sepse “çdo njeri e di se demokracia është rregull të jetuarit. Por demokracia nuk mund të jetë rregull e të jetuarit në tirani. Ky është koncepti i diversitetit, i cili duhet të mbrohet nga demokracia dhe të mbrojë të drejtat nga tirania”.

Profesor Kamusella, pasi elaboroi në mënyrë shkencore termin diversitet, e që nënkuptojmë balancimin e një shoqërie, drejtat e së cilës njihen me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e minoriteteve, por ka thënë se janë kryesisht ata popuj të cilët vendosin politikën e një shteti dhe pranojnë di-



versitetin e pakicave të tjera që jetojnë në atë shtet. Ai mori shembull Finlandën dhe Suedinë, ku tha se këto dy vende më parë kanë qenë në luftë mes vete, por që tani janë një shembull i mirë i pranimi të diversitetit mes këtyre popujve të këtyre dy shteteve.

Profesor Kamusella, duke marrë këtë shembull tha se në një të ardhme edhe Kosova do të mund të kishte të njëjtin diversitet mes shqiptarëve dhe serbëve që jetojnë në Kosovë. Po ashtu dha shembuj për shumë shtete të cilat kanë pasur

transformime në periudha të ndryshme historike, të cilat kanë pas këtë problem, duke e cituar vitin 1990 kur u ribashkuan dy Gjermanitë, pastaj në vitin 1991 kur u shpërbë Bashkimi Sovjetik, në vitet 1991-2 kur ngjau rënia e komunizmit në Shqipëri, në 1993 kur u shpërbë Çekosllovakia dhe vitet 1991-2008 kur u shpërbë Jugosllavia. Po ashtu prof. Kamusella ka thënë se Zvicra shihet si homogjene nga banorët e saj, sepse tërë populli zviceran është i përbërë nga të gjithë qytetarët zviceranë, pavarësisht

nga çdo dallimet fetare apo gjuhësore, kurse të huajt e shohin Zvicrën si të ndryshme për shkak të katër gjuhësisë.

Në fund të ligjëratës pati edhe një debat, ku studentët e Kolegjit AAB parashtruan pyetje, të cilave iu përgjigj profesori skocez, prof. dr. Tomasz Kamusella.

Gjithashtu prof. Kamusella dhe shoqëruesi i tij Bardhyl Selimi takuan edhe me menaxhmentin e AAB-së me të cilën biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore.



Arkitekti zviceran Mayer ligjëratë speciale, studentëve të AAB-së: Punoni vetëm projekte të mëdha!

Ligjëratat në temën “Roli i arkitekturës dhe urbanizmit në transformimin e shoqërisë”, e cila u mbajt nga arkitekti zviceran Michael Mayer, para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës të Kolegjit AAB, kryesisht u përqendrua tek evoluimi i industrisë dhe krijimeve që njeriu i ka sjellë përgjatë shekullit XX, e deri në ditët e sotme, ku sektori i arkitekturës, ndërtimtarisë dhe urbanizmit përveç që janë partner të këtij evoluimi janë edhe përfitues. Ai foli për stafin dhe nive-

lin e tyre të shkollimit, të cilët punojnë në zyrën e tij projektuese në Zvicër, dhe praktikën e saj, që në vazhdimësi të punojnë vetëm me projekte të mëdha. Duke folur për projektet, të cilat i realizon kjo zyre, arkitekti Mayer i përmendi disa shembuj nga projektet që i kanë përfunduar kryesisht në qytetin e Gjenevës gjatë shekullit XX, si qendrat historike, zonat industriale dhe artizanate, dhe zonat tjera të përziera, të cilat janë kryesisht të banueshme.

Arkitekti Mayer ka thënë se

urbanizmi u është përgjigjur kërkesave të tjera, zgjidhjeve të kërkesave të banimit me banesa me ndërtime të larta, të cilat më herët nuk kanë ekzistuar.

Pjesa e dytë e ligjëratës kryesisht u përqendrua me shembuj konkret dhe riprojektme të objekteve, të cilat kanë qenë ndërtime të vjetra dhe janë kthyer në ndërtime të banimit të reja, në ndërtim të sallave të sportit, të teatrove, e shumë të tjera.

Gjithashtu arkitekti Mayer u takua edhe me menaxhmentin e AAB-së dhe

biseduan për vazhdimin e bashkëpunimit në fushën

akademike, shkencore dhe atë kulturore.



20 studentë të përzgjedhur do të jenë pjesë e sistemit tutorial të AAB-së gjatë viti akademik 2015/16



Krahas aktiviteteve të vazhdueshme në përputhje me planprogramin universitar, këto ditë është përmbyllur konkursi për përzgjedhjen e studentëve tutorë, për vitin akademik 2015/16. Tutorët studentë, janë përzgjedhur në të gjitha programet e studimit që organizohen në të tre kampuset e Kolegjit AAB në Prishtinë, Gjakovë dhe Ferizaj.

Studentët e përzgjedhur në këtë konkurs për tutorë janë këta:

AAB Prishtinë
Elbasan Hamiti-
Kulturë Fizike dhe Sport,
Alban Lahu-
Shkenca Kompjuterike,
Visar Agushi-
Juridik,
Mergime Lanaj-
Administratë Publike,
Lendita Peli-
Shkenca Sociale,
Agesa Balaj -
Gjuhë Angleze,
Donika Blaku-
Gjuhë Angleze,

Drin Demiri-
Komunikim Masiv,
Valentina Lenjani,
Orgest Lahu dhe
Luljeta Hasanaj-
Ekonomik,
Nikoll Pnishi dhe
Diellza Hajdari-
Psikologji.

AAB Ferizaj
Liridon Gabrrica-
Ekonomik,
Krenar Cermini dhe
Fllanza Ymeri –
Gjuhë Angleze,
Paris Guri-
Administratë Publike.

AAB Gjakovë
Marigone Deda-
Juridik,
Medaura Fazlija -
Ekonomik,
Arjan Ukmata-
Gjuhë Angleze.

Rëndësia e sistemit tutorial të studentëve është që të bëhen ndryshime në të mirën e Kolegjit dhe në të mirën e studentëve.



Studentët e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB vizituan Komandën e Forcës së Sigurisë të Kosovës

Në vazhden e përpjekjeve për të aplikuar forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mësimdhënësit e Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, Mensut Ademi dhe Avni Alidemaj, në kuadër të lëndës Praktika Juridike, organizuan vizitë studimore në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) në Prishtinë. Pjesëmarrës në vizitë ishin një grup i mësimdhënësve dhe rreth 70 studentë të Fakultetit Juridik nga kampusi i Prishtinës dhe ai i Ferizajt.

Gjatë vizitës studimore, studentët patën mundësinë të njihen për së afërmi me FSK-në. Gjenrallejtënant Rahman Rama shpalosi sukseset e arritura në zhvillimin e FSK-së, për bashkëpunimin

rajonat e ndërkombëtar, për partneritetin e ndërtuar me vendet anëtare të NATO-së, për ngritjen profesionale, trajnimin, shkollimin, pajisjet dhe të ardhmen e FSK-së. Për më tepër, kolenel Ilir Qeriqi foli edhe për përfshirjen e femrave dhe të bashkësive minoritare në FSK dhe shpalosi fushëveprimtarinë e këtij institucioni të rëndësishëm: pastrimin e fushave të minuara, operacionet e kërkimit shpëtimit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, etj. Gjithashtu janë përmendur sukseset e pjesëtarëve të FSK-së të shkolluar jashtë vendit.

Studentët mësuuan për strukturën, organizimin, misionin dhe planifikimin për trans-

formim të Forcës së Sigurisë. Ndërsa, nga pjesëtari i zyrës ligjore të FSK-së, Kapiten Muhamet Thaqi, mësuuan për bazën ligjore të funksionimit të Forcës së Sigurisë dhe me theks të veçantë për misionin dhe mandatin e Policisë së FSK-së.

Studentët parashtruar një mori pyetjesh lidhur me të ardhmen e FSK-së, kriteret e pranimit, kodin e mirësjelljes, etj.

Në këtë mënyrë studentët janë ndarë të kënaqur me informacionet e dorës së parë që patën mundësi t'i marrin dhe të cilat do të ju nevojiten në formimin e përgjithshëm profesional.



**English
Language
Academy**

OFERTË PROMOCIONALE

PËR STUDENTËT E KOLEGJIT AAB
TË CILËT REGJISTROHEN NË GRUPET E PARA

ÇMIMI MUJOR 15€

**KURSET FILLOJNË NGA
27 SHKURT 2016**

**TANI NË ELA KURSE
TË GJUHËVE TË HUAJA
GJUHË GJERMANE
DHE GJUHË FRËNGE**

Lulzim Tafa, fitues i çmimit të parë për letërsi “Ramadan Sinani”

Shoqata e Botuese e Shqiptarëve në Maqedoni, në kuadër të Panairit të Librit “Tetova 2015”, të organizuar në hapësirat e Qendrës Nacionale për Kulturë në Tetovë, këtë vit ndau edhe çmimin “Ramadan Sinani”.

Çmimi “Ramadan Sinani” u nda nga kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, dhe iu dha poetit nga Republika e Kosovës, Lulzim Tafa. Poeti Tafa duke pranuar çmimin ka thënë: “Janë dy arsye që më bëjnë që të

ndjem i nderuar dhe i privilegjuar me këtë çmim, e para se ky çmim ndahet në një festë të librit këtu në Tetovë, e që për ne kosovarët Tetova ka qenë dhe mbetet dashura jonë e madhe, dhe tjetra për faktin se ky çmim e mban emrin e poetit dhe intelektualit të shquar Ramadan Sinani, me veprat e të cilit jam njohur si studentë e sidomos me librin e tij, “Kavallet e Sharrit”.

Ndërsa, kryetari i jurisë Salajdin Salihu, në arsyetimin e dhënies së çmimit ka thënë

se; Lulzim Tafa ka arritur të krijoj një vepër poetike ku ndjehet magjia gjuhësore. Lirikat e tij shquhen për ekonomizimin e skajshëm të fjalëve, shpeshherë poezitë e tij janë sentenciale, e herë pas here me kthesa befasuese dhe mbresëlënëse. Përveç përfaqësuesve të institucioneve, me rastin e ndarjes së çmimit morën pjesë edhe shumë dashamirë të librit dhe kulturës në përgjithësi.



Botime të reja: “Historia e shtetit dhe së drejtës”, autor Muhamet Kelmendi

Shtëpia Botuese AAB ka botuar librin më të ri shkencor “Historia e shtetit dhe së drejtës”, të autorit prof. dr. Muhamet Kelmendi, me redaktor përgjegjës prof. dr. Lulzim Tafa.

Në parathënien e librit, autori thotë se lënda e historisë së shtetit dhe të së drejtës i takon grupit të lëndëve nga lëmi juridik, politik e shoqërori së kaluarës. Ajo tregon shkaqet që ndikuan në lindjen e shtetit, pra të institucioneve shtetërore dhe të së drejtës, të cilat u krijuan krahas lindjes sëpronës private dhe të ndarjes së shoqërisë në klasa. Po ashtu në këtë hyrje autori thekson se këto dy fusha mund të kapen të ndara, të analizohen dhe studiohen, por edhe të ndërlidhen midis tyre, por kuptimin më të qartë e kanë vetëm kur gjenden në lidhshmëri në mes veti, sepse kështu mund të shpjegohen më qartë si lëndë dhe si fushë e shkencës shoqërore-juridike.

Libri gjithsej ka tetë ka-



pituj, 304 faqe, ndërsa në listën e literaturës së konsultuar, radhiten mbi 75 libra tjerë shkencorë.

Libri “Historia e shtetit dhe së drejtës”, tanimë gjendet në bibliotekën e AAB-së, për të gjithë lexuesit e interesuar.

Prof. dr. Muhamet Kelmendi, deri më sot ka publikuar një varg titujsh punimesh shkencore, në revista prestigjioze, dhe është profesor i regullt dhe dekan në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB.

Studentët e Komunikimit Masiv në AAB, pjesëmarrës në Festivalin “International Peace&Film Festival” në SHBA

Artan Avdiu dhe Shqipërim Selimi, studentë të Fakultetit të Komunikimit Masiv, drejtimi Produksion, në AAB, kanë realizuar filmin “Mungesa”, ku pas aplikimit filmi menjëherë është nominuar në kategorinë “Student Short Film” dhe “Ambassador of Peace”, në festivalin “Internacional Peace& Film Festival”, në Orlando të Floridas, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Artan Avdiu dhe Shqipërim Selimi, kanë thënë se në fillim filmin e kemi realizuar vetëm për një projekt në kuadër të lëndës “Montazh” në fakultetin ku jemi duke studiuar, por pas kritikave të mira që i kemi marrë nga mësimdhënësit e lëndës si Zijad Mehić dhe

Albin Xharra, kemi vendosur që ta dërgojmë në festivalin ndërkombëtar “International Peace& Film Festival”.

“Njohuritë e fituara nga lënda e montazhit dhe përgjithësisht nga lëndët e vitit të parë, na kanë ndihmuar për realizimin e filmit “Mungesa”, dhe disa projekte të tjerat që i kemi në realizim e sipër”, ka thënë Artani.

Filmi “Mungesa” është film i metrazhit të shkurtër. Filmi trajton mungesën dhe rëndësinë e ujit në jetën e njeriut.

Regjia, skenari dhe montazhi i filmit është realizuar nga Artan Avdiu dhe Shqipërim Selimi, drejtor fotografie Adil Beqa, aktorët, Festim Sokoli dhe Edion Hoxha.





4.5 cent / minutë

ME TË GJITHË OPERATORËT NË KOSOVË
AKTIVIZIMI 2 € NË MUAJ

AKTIVIZIMI

Përmes SMS-it në numrin
50555

me tekstin
Vala Classic

STATUSI

Përmes SMS-it në numrin
50555

me tekstin
Classic status

 **0800 10000**

www.kosovotelecom.com


Botime të reja:

“Fjalor shpjegues latinisht-shqip”, autor Asllan Bilalli

Shtëpia Botuese AAB ka botuar fjalorin më të ri shkencor “FJALORI SHPJEGUES LATINISHT-SHQIP”, të autorit prof. dr. Asllan Bilalli, me recensentë prof. dr. Hajredin Kuqi dhe prof. dr. Qerim Qerimi.

Në parathënien e librit, autori thotë seky fjalor në shumë aspekte u nevojitet të gjithë juristëve, duke filluar nga studentët, aplikuesve të së drejtës në praktikë, e po ashtu edhe profesorëve të drejtësisë. Juristët romakë shumë rregulla juridike, përkufizime, dhe institute arritën që gjatë 20 shekujve t'i formulojnë në gjuhën latine në mënyrë gjithëpërfshirëse, të qartë dhe koncize, kështu që juristët bashkëkohorë të të gjitha rajoneve të ndryshme gjuhësore ende nuk arritën t'u ofrohen, e as t'i tejkalojnë. Andaj edhe në kushte bashkëkohore nëse juristët dëshirojnë që rregullat konkrete, ose definicionet t'i shprehin qartë dhe kuptueshëm janë detyruar të shërbejnë me të arriturat e juristëve që kanë shkruar në gjuhën latine.

Në fund të parathënies, autori thekson se fjalori do t'u



shërbejë të gjithë atyre që dëshirojnë t'i thellojnë njohuritë për mendimin juridik, nocionet dhe institute juridike në gjuhën latine.

Fjalori në fjalë gjendet edhe në bibliotekën e AAB-së, e cila do të jetë në dispozicion të studentëve dhe stafit të këtij institucioni, për qasje sa më të thellë në botën e shkencës e hulumtimit profesional.

Prof. dr. Asllan Bilalli përveç që është studiues i thellë në fushën e drejtësisë, deri më sot ka publikuar një varg punimesh në revistat më prestigjioze, dhe është profesor rregullt në Fakultetin Juridik të Kolegjit AAB.

“Historia e një fotografie” fitoi çmimin për filmin më të mirë



Në një orë të hapur me studentët në ambientet e Kolegjit AAB, u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve kryesore për kategorinë e filmit shkurtër, të punuar nga studentët e Fakultetit të Komunikimit Masiv, Gazetari dhe Produksion.

Prof. Adrian Krasta shtoi se për vlerësimin dhe ndarjen e çmimeve komisioni përzgjedhës i kanë ndarë këta fitues:

Çmimi për producentin më të mirë, fitues është Altin

Bogiqi, çmimi aktori më i mirë, fitues është Lent Zeqiri dhe Ideal Berishaj, çmimi aktorja më e mirë, fituese është Elona Blakaj, çmimin montazhier më i mirë, fitues është Rinor Kadriu, çmimin për fotografimin dhe kamerën më të mirë, fitues është Lorik Krajкова, çmimi për skenarin më të mirin, fitues është Lorik Krajкова dhe AlmaCocja, çmimi regjisor më i mirë, fitues është Rona Muçolli dhe Leutrim Krasniqi, dhe çmimin për

filmin më të mirë “Historia e një fotografie”, fitues Alma Cocaj dhe Lorik Krajкова, e të cilin çmim e dha ish studentja e AAB-së, Linda Metaj.

Pas ndarjes së çmimeve u shfaq edhe filmi fitues, “Historia e një fotografie”.

Të gjithë studentët fitues të çmimeve të përmendura e falënderuan Kolegjin AAB, që u ka dhënë mundësinë dhe kushtet nga më të mirat.

U promovua libri “(Mos)zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë” i autorit Arsim Sinani

Në ambientet e Universitetit European të Tiranës u promovua libri “(Mos)zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë”, i autorit Arsim Sinani, botim i UET-Press.

Libri “(Mos)zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë” sjell një analizë të thellë të historikut të shqipes në ish- Jugosllavi e më pas në republikën e re të Maqedonisë deri më sot. Arsim Sinani duke folur para një auditori ku nuk mungonin politikanë e analistë nga Tirana, Mali i Zi e Maqedonia, si dhe pedagogë e studentë, ka thënë se në këtë libër ka sjellë disa teza që kanë të bëjnë me gjendjen aktuale të shqiptarëve

në Ballkan. “Ne po shkojmë drejt krijimit të shtetit të tretë shqiptar në Ballkan dhe kjo është Republika e Maqedonisë, dhe maqedonasit duhet ta kuptojnë me shumë dashamirësi se ne duam të ndërtojmë me ta një shtet, të bëjmë një marrëveshje historike, për shkak se përballë grekëve, serbëve dhe bullgarëve, vetëm me ne mund të mbijetojnë dhe ky është mesazhi që unë i dërgoj inteligjencës së re maqedonase që të merremi vesh, sepse në këtë drejtim do të kenë mbështetjen tonë”, – tha ndër të tjera ai. Arsim Sinani duke u ndalur tek problemet me të cilat përballet gjuha shqipe sot, jo vetëm në Maqedoni, por

edhe në Mal të Zi e Luginë të Preshevës, këmbënguli disa herë gjatë fjalës së tij, se gjithçka duhet të nisë nga Tirana zyrtare, në mënyrë që këtyre problemeve t'i jepet fund njëherë e mirë.

Ndërsa prof. dr. Romeo Gurakuqit gjatë promovimit të librit “(Mos)zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë” ka thënë se libri është një studim krahasues, i përqendruar në periudhën 1991-2014 dhe shumë më pak në periudhën e ish-Jugosllavisë së dytë. Autori merret me analizën historike dhe juridike të procesit aktual të njohjes së gjuhës shqipe në shtetin fqinj.

Në fund të promovimit të

librit u zhvillua një debat mjaft interesant në mes të studentëve dhe autorit të librit, ku kryesisht u debatua përmbajtja e librit dhe ngjarjet që pasqyrojnë librin.

Arsim Sinani ka botuar një varg punime shkencor në revista vendore dhe ndërkombëtare dhe është profesor i rregullt në Kolegjin AAB.





E-topup INTERNET



Prej tash, mund të bleni direkt mbushje elektronike të pakove për **INTERNET** në të gjitha **pikat e shitjes VALA**

1GB

INTERNET

1.50 €
7 ditë**2GB**

INTERNET

3.00 €
31 ditë**3GB**

INTERNET

4.50 €
31 ditë**5GB**

INTERNET

7.50 €
31 ditë **0800 10000**www.kosovotelecom.com

Në AAB u promovua libri “Mashtrimi i madh”, autor Bardhyl Mahmuti



Në Kolegjin AAB në Prishtinë, u bë promovimi i librit “Mashtrimi i madh”, i autorit Bardhyl Mahmuti. Këtë libër e ka botuar Shtëpia Botuese “Çabej”. Ky libër i ka 600 faqe, që është i sistemuar në dy pjesë, përkatësisht në tërësi ka dhjetë kapituj.

“Ky libër, që është i pashoq në krijimtarinë faktike kosovare dhe gjithëshqiptare, karakterizohet me dendësinë e dëshmime argumentuese dhe bindëse përmes dëshmitarëve oku-

lar dhe aktorëve dhe veprave vrastare të kryera në Kosovë”, ka thënë ndër të tjera prof. dr. Ramë Buja, i cili më pastaj shtoi se ky libër ka veçanti dalluese, sepse lexuesi mrekullohet sidomos me formën e vjeljes së fakteve të atyre që kanë shkaktuar tragjedinë në këto troje. Me një fjalë autori ka kurajën që të argumentojë kujdesshëm vërtetësinë e të ndodhurave të të gjitha masakrave gjenocidale në Kosovë, përfundoi Buja.

Ndërsa prof. Fatmir Arifi, duke folur për librin “Mashtrimi i madh”, tha se motivimi për t’u shkruar ky libër qëndron në dy ngjarje që e bëri të domosdoshëm daljen e këtij libri në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja. Në fakt, arsyeja kryesore qëndron në ndriçimin e fakteve se në Kosovë ka ndodhur gjenocid i shkaktuar nga shteti serb, kurse arsyeja e dytë është që ky gjenocid edhe sot po synohet të modifikohet nga qarqe të ndryshme. Zotri Arifi ka shtuar se ky libër përmban një vlerë të madhe historike, juridike dhe sociologjike për sa i përket analizës së saktë kronologjike dhe zbulimit të ngjarjeve në dekadën e fundit të shekullit që lamë pas. Duke i falënderuar të pranishmit, e ne veçanti profesorët dhe studentët e AAB-së, por edhe të ftuar të tjerë, autori i librit, Bardhyl Mahmuti ka thënë se tre

kapitujt e parë të pjesës së parë të librit tim që trajtojnë çështjen e gjenocidit në Kosovë, i kushtohen tri rasteve më të mediatizuara të vrasjeve të civilëve: “Rastit të Kleçkës”, “Rastit në kafenenë Panda” dhe “Rastit zë Reçakut”. Ndriçimi i këtyre tri ndhohive, si dhe vrasjet gjatë operacionit “Patkoi”, mundësojnë të shihen të gjitha pasojat e luftës në Kosovë si rezultat i politikës gjenocidale, që e zbatoi shteti serb ndaj shqiptarëve.

Në fund autori ka tha se çdokush që do ta lexoj këtë libër do të kuptoj se kush në fakt qëndron prapa vrasjes së civilëve në Kosovë, dhe se çka përmbajnë listat e krimeve që i mëvishen UÇK-së, etj.

Në fund të promovimit të librit u zhvillua një debat mjaft interesant në mes të studentëve dhe autorit të librit, ku kryesisht u debatua përmbajtja e librit dhe ngjarjet që pasqyrojnë librin.



Doli numri më i ri i revistës shkencore THESIS, me punime nga konferenca “Informacioni global përballë kulturave kombëtare”

Doli nga shtypi numri më i ri i revistës kërkimore-ndërkombëtare THESIS, me ISSN dhe Bord Ndërkombëtar, botim i Kolegjit AAB. Në këtë numër tematik janë përfshirë punime nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për komunikimet dhe studimet mediatike, “Informacioni global përballë kulturave kombëtare”, e cila u organizua nga Fakulteti i Komunikimit Masiv i Kolegjit AAB në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës, Ecole Supérieure de Journalisme të Parisit, shkolla më e vjetër e gazetarisë në botë dhe IPAG Business School të Parisit, e cila i zhvilloi punimet më 29-30 maj të vitit 2015, në Kolegjin AAB në Prishtinë.



Kryeredaktori i kësaj reviste Masar Stavileci, dhe zv/kryeredaktori Hasan Saliu, në vend të editorialit, në një shkrim të tyre kanë shkruar se konferenca “Informa-

cioni global përballë kulturave kombëtare”, kishte për qëllim që të bëjë bashkë studiuesit e komunikimit masiv dhe medieve nga viset mbarëshqiptare dhe më gjerë; për të prezantuar gjetjet e kërkimeve të tyre mediatike; të shtojë përvoja, ide dhe të diskutojë për çështje të tjera relevante profesionale, duke i parë ato nga perspektiva historike.

Në konferencën në fjalë ishin prezantuar 45 kumtesa, ndërsa 29 punime janë përfshirë në revistën e cila ka gjithsej 800 faqe, në shqip dhe anglisht.

Numrin e ri të revistës mund ta merrni në bibliotekën dhe librarinë e AAB-së, dhe mund ta shfletoni gjithashtu edhe në uebfaqen zyrtare të Kolegjit AAB.

Studentët e Produksionit Medial të Fakultetit të Komunikimit Masiv vizituan studiot e serialit “O sa mirë”



Një grup i studentëve të Fakultetit Komunikim Masiv dhe Produksion, të shoqëruar nga mësimdhënësja Burbuqe Berisha, vizituan studiot e serialit “O sa mirë”, serial ky që është realizuar në regji të Ilir Bokshit e në podukcion të DigiAlb.

“Përveç njohurive tjera, studentët nga afër e kanë pa punën praktik se si xhirohet filmi televiziv artistik”, tha ligjëruesja Berisha. Studentët që ishi në të pran-

ishëm në vizitë:

Albulena Balaj, Gentrit Ahmeti, Hekuran Bytyqi, Engjull Sokoli, Krenar Arllati, Egzon Keqmezi, Bajram Emmini, Shkelqim Hertica, Bujar Maliqi, Besnik Banushi, Arian Dushi, Blendi Rama, Arlin Gruda, Leonora Dobrunaj, Endri Dermaku, Artan Avdiu, Shqiperim Selimi, Altin Hykolli, Bardhyl Limani dhe Flamur Thaqi.

Facebook-u njofton përdoruesit kur përgjohen nga qeveria



Llogaritë e Facebook-ut shpeshherë janë cak i hakërëve. Kohëve të fundit kjo është shtuar dukshëm, dhe për të ndaluar këtë rrjetin më i madh social ka njoftuar se synon të njoftojë të gjithë përdoruesit, llogaritë e të cilëve janë sulmuar nga qeveria ose dikush tjetër i dyshuar në Facebook.

Në një postim në një blog, Facebook-u ka thënë se privatësia e përdoruesve të rrjetit është gjëja më e rëndësishme.

“Teksa kemi ndërmarrë hapa për të siguruar llogaritë që besojmë se janë në rrezik, andaj kemi vendosur

t’ju njoftojmë me informata shtesë kur kemi dyshime të forta që një sulm i sponsorizuar nga qeveria është duke ndodhur. Do e bëjmë këtë sepse sulmet e tilla janë më të avancuara dhe të rrezikshme në krahasim me tjerat, dhe inkurajojmë njerëzit e ndikuar që të marrin aksionet e nevojshme për të ruajtur gjithçka që kanë në llogaritë e tyre”, thuhet në postimin e Facebook-ut për sigurinë në këtë faqe. Facebook-u po ashtu thotë se këto njoftime nuk do të thotë që uebfaqja si e plotë është në rrezik.

Harrojeni Wi-Fi, rrjeti i ri Li-Fi është 100 herë më i shpejtë


Teknologjia e fundit e internetit mund ti rrezatoj të dhënat tuaja duke e përdorur fuqinë e dritës dhe është në pragun e revolucionit sa i përket mënyrave se si ne shfetojmë në internet.

Deri tani kjo teknologji e re – e njohur si Li-Fi – është testuar vetëm në ambiente të kontrolluara por shkencëtarët së fundmi e kanë instaluar atë në botën reale dhe rezultatet janë të mahnitshme.

Gjatë provave në Estoni, janë incizuar shpejtësi prej 1GB për sekondë, që është rreth 100 herë më shpejtë se sa shpejtësia e internetit që e kemi në shtëpi. Boston University have illustrated how the light-based internet is disseminated around the home

“Ne jemi duke i bërë disa projekte si provë brenda disa industrive të ndryshme ku ne mundemi me përdorë teknologjinë VLC”, thotë për IBTimes UK Deepak Solanki, drejtor i kompanisë Velemini.

“Për momentin ne kemi dizajnuar një zgjidhje të



ndriçimit të mençur për një ambient industrial ku komunikimi kryhet përmes dritës. Ne gjithashtu jemi duke i bërë disa projekte si provë me një klient privat ku ne do ta instalojmë rrjetin Li-Fi në zyrat e tyre dhe ata mund të kenë qasje në këtë rrjet”, ka shtuar ai.

Li-Fi është krijuar në vitin 2011 nga Harald Haas dhe përveç që është shumë i shpejtë është edhe më i sigurt dhe i besueshëm sesa lidhja tradicionale me Wi-Fi. Teknologjia e përdorë VLC, që në parim punon si një formë jashtëzakonisht e avancuar e kodit Mors.

Drita të cilën e prodhon është aq e shpejtë saqë nuk

mundet të shihet me syrin tonë.

Por, fatkeqësisht kjo teknologji e re nuk do të jetë në shtëpitë e juaja së shpejtë.

Shtëpitë, zyrat, dyqanet tona etj., janë të mbushura të gjitha me infrastrukturën për të prodhuar Wi-Fi dhe ti heqësh të gjitha këto për ti zëvendësuar me teknologjinë Li-Fi është shumë e kushtueshme.

Veç kësaj edhe paisjet të cilat ne i përdorim duhet ta kenë opsionin e Li-Fi dhe derisa të bëhet një gjë më e zakonshme kompanitë e teknologjisë do të qëndrojnë me Wi-Fi.

Lajme të reja dhe për Messenger

Krishtlindjet vijnë me lajme të reja dhe për Messenger, chat-in e Facebook. Rrjeti social ka publikuar disa funksione ad hoc për ta bërë më interesante bisedën mes miqsh, dhe për të lehtësuar shpërndarjen e fotove.

PhotoMagic ka qenë në testim në Australi në nëntor, dhe shfrytëzon teknologjinë e njohjes së fytyrës së miqve sapo bëni një foto, duke i dhënë mundësi përdoruesve të Messenger të krijojnë një grup të shpejtë të miqve me të cilat të shpërndajë këto foto.

Por ky element lihet në dorë të zgjedhjes së përdoruesit, qoftë për të njohur fytyrat e miqve të tij, apo qoftë edhe fytyra e tij të njihet në fotot e të tjerëve. Megjithatë, ky funksion nuk pritet të jetë funksional në Evropë pas



përplasjeve me autoritetet evropiane lidhur me privatësinë.

Megjithatë për vendet tona do të vijnë detaje të personalizuara për festat. Për shembull flokë dëbore që zbresin në ekran kur dërgon apo kur merr një emoticon

të lidhur me dimrin, apo dhe një paketë e re ngjyrash festash, dhe personalizimi i ngjyrës së preferuar në detaje të tjera të chat-it.

Përgatiti: gazetaknn.com

Zvicra hedh në qarkullim autobusë pa shoferë

Njihet si një prej vendeve me nivelin më të lartë të jetesës, por shpesh herë shell risi në teknologji.

Bëhet fjalë për Zvicrën që pranverën e ardhshme, pritet të hedhë në qarkullim autobusë pa shofer.

Fillimisht do të hidhen në qarkullim dy autobusë të tillë në qytetin e Sionit. Këta

autobusë janë projektuar të mbajnë deri në 9 persona të rritur. Autobusët do të jenë pjesë e një eksperimenti, për të kuptuar nëse përmbushin parametrat e sigurisë dhe nëse në të ardhmen mund të hidhen të tjera mjete.

Ky lloj autobusi nuk kalon mbi 20 kilometra në orë shpejtësi.



Kombëtarja e Shqipërisë bëri historinë

Viti 2015 u karakterizua si viti më i suksesshëm i futbollit shqiptar.

E gjithë Shqipëria festoi fitoren e kombëtares së saj të futbollit ndaj Armenisë, e cila solli kualifikimin historik në finalen e Europianit Francë 2016. Për herë të parë futbollit shqiptar bëhet pjesë e ngjarjes më të rëndësishme në nivel evropian të këtij sporti.

Kombëtarja shqiptare e drejtuar nga tekniku italian Gianni De Biasi fitoi 3-0 ndaj Armenisë në fushën e kësaj të fundit, duke siguruar në këtë mënyrë vendin e dytë në grup. Ndeshja nisi me autogol nga një mbrojtës armen në minutën e 10 dhe pjesa e parë u mbyll me një gol tjetër nga shqiptari Gjimshiti. Në pjesën e dytë Sadiku shënoi golin e tretë, duke sjellë sigurinë e plota që ekipi shqiptar i futbollit u kualifikua për herë të parë në një kampionat evropian. Fitorja me Armeninë fashiti mërzinë e opinionit sportiv për humbjen e Shqipërisë përballë Serbisë në Elbasan. Heshtja dhe protestat për atë humbje ia la vendin

festimeve që nisën në kryeqytetin shqiptar, megjithë shiun e rrëmbyer, e që u përhapën me shpejtësi në të gjitha qytetet. Kudo makinat dhe njerëz të shumtë me flamujt dhe simbolet kombëtare pushtuan sheshet dhe rrugët, të shoqëruara nga bori, thirrje gëzimi e këngë patriotike apo fishekzjarre. Në Elbasan, aty ku kombëtarja luajti ndeshjet e saj, për tifozët u hapën dyert e stadiumit.

Të njehta skena festimesh u zhvilluan dhe në Prishtinë, e qytetet të ndryshme në Kosovë, apo dhe Maqedoni ku shqiptarët ju bashkuan gëzimit për kualifikimin e kombëtares.

“Është një lumturi e madhe, sepse arritën të realizonim një ëndërr që as nuk mendohej”, deklaroi nga Armeni trajneri De Biasi. Ai tregoi se përpara ndeshjes lojtarët ishin shumë nervozë. “Para se të hynin në fushë u thashë: Të luajmë deri në fund. Jemi më të fortë se ata. Deri tani keni bërë gjëra të jashtëzakonshme, prandaj lë të cojmë në shtëpi fitoren”, rrëfeu De Biasi. Për kapitenin e ekipit, Lorik Cana,



i cili shpërtheu në lot në përfundim të ndeshjes kualifikimi “është një ëndërr që u bë realitet”. Ndërsa presidenti i Federatës shqiptare të futbollit Armando Duka foli për “një kualifikim të merituar. Kjo kuadër besoi deri në fund. Ka qenë një edicion i jashtëzakonshëm”, deklaroi zoti Duka.

Kualifikimi historik i kombëtares së Shqipërisë u përshëndet dhe nga drejtuesit kryesorë politikë të vendit, ndërsa Presidenti Bujar Nishani, që njëtoi

vendimin për të nderuar ekipin me titullin “Nderi i Kombit” me motivacionin “Në vlerësim të arritjes historike të kualifikimit për në fazën finale të Kampionatit Evropian ‘Francë 2016’, për rezultatet e shkëlqyera sportive që mundësuan këto fitore si dhe për lartësimin e imazhit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në botë duke na bërë më krenarë e të bashkuar se kurrë”.

Kombëtarjes shqiptare ju organizua një pritje madhështore nga tifozët e

shumtë. Ekipi shqiptar arriti të mblidhte pikë të rëndësishme në grupin jo të lehtë përballë Portugalisë, Danimarkës, Serbisë, dhe Armenisë, duke e renditur e dyta. Kualifikimi I saj zuri vend thuajse në të gjitha mediat e rëndësishme evropiane, të cilat nënvizonin faktin e pjesëmarrjes së saj për herë të parë në një finale evropian, e duke quajtur këtë “historike” për kombëtaren e Shqipërisë.

Historike: Sigal Prishtina kampione e Ligës Ballkanike

Në Ligën Ballkanike shkruhet historia. Sigal Prishtina është kampionja e kësaj lige për sezonin 2014/2015, pasi që skuadra kosovare, mposhti edhe në ndeshjen e dytë skuadrën bullgare, Rilski, me rezultat 71:80.

Sigal Prishtina e pati fituar edhe ndeshjen e parë në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, me rezultat 74:72.

Kjo është hera e parë, që një skuadër nga Kosova, triumfon në Ligën Ballkanike,

dhe kjo arrihet vetëm në vitin e dytë të pjesëmarrjes, dhe ky triumf vjen, pak kohë nga pranimi i Kosovës me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit, FIBA.

Edhe pse çereku i parë u takoi bullgarëve të Rilskit me rezultat 26:22, përballja në këtë çerek, ishte shumë e barabartë, dhe ishin disa momente që e përcaktuan fituesin e këtij çereku

Majlinda, Distria dhe Nora transferohet te gjiganti evropian



Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi janë transferuar te Galatasaray. Tri xhudistet më të mira në Kosovë, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, janë transferuar përkohësisht në Galatasaray.

Në fakt, ato së bashku me trajnerin Driton Kuka do ta përfaqësojnë klubin turk në evenimentin Golden

League, i njëjtë me Champions Leaguen e futbollit. Ky eveniment do të mbahet në Vjenë, më 19 dhjetor, ndërsa ekipi kosovar do ta marrë rrugën drejt kryeqytetit austriak të enjten. Trajneri Kuka beson se garueset e tij mund të fitojnë medalje në eksperiencën e tretë në Golden League. Ato ushtruan së fundmi në Japoni dhe janë të gatshme për këtë eveni-

ment, të fundit për këtë vit. “Do të shkojmë atje me tri garuese, Majlindën, Norën dhe Distrinë.

Kemi bërë stërvitje të mira në Japoni. Do të duhej të marrim medalje, edhe pse shumica e klubeve janë të përforcuara shumë. Kjo është hera e tretë që marrim pjesë në këtë eveniment”, u shpreh Kuka.





**Bleje banesën me këste
për 3 vite pa kamatë**

Gëzuar Viti i Ri

2016



Prishtinë – Kosovë, Tel: +386 (0)49 672 000, +377 (0)45 295 006, +386 (0)49 132 056
web: www.modelslovenia.com , mail: info@modelslovenia.com

cilësi, leadership, sukses!



Kolegji AAB

EKONOMIK

- BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET
- MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI
- MENAXHMENT DHE INFORMATIKË

SHKENCA KOMPJUTERIKE

- INXHINIERI SOFTUERIKE
- KOMUNIKIMI NË RRJETA
- TELEKOMUNIKIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT (IT)
- MEKATRONIKË

MENAXHIM SEKTORIAL

- MENAXHIMI I ARSIMIT
- MENAXHIMI I KULTURËS
- MENAXHIMI I SPORTEVE
- MENAXHIMI I SHËNDETËSISË

JURIDIK

KRIMINALISTIKË

INTEGRIME EVROPIANE

KUJDESI DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE

PSIKOLOGJI

GJUHË ANGLEZE

KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI

- GAZETARI
- PRODUKSION

ADMINISTRATË PUBLIKE

SHKENCA POLITIKE DHE DIPLOMACI

KULTURË FIZIKE DHE SPORT

ARKITEKTURË

DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA

DIZAJN ENTERIERI

DIZAJN I MODËS

PIKTURË DHE ARTE VIZUELE

MUZIKË

AAB ju ofron mundësinë që të studioni në gjuhën angleze në Programet Ndërkombëtare të Universitetit të Londrës

London School of Economics and Political Science:
me programet **Bachelor** dhe
Royal Holloway me programet **Master**

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Tel: 038/ 555 444; 038/ 601 019

Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666

Dega në Gjakovë: 045/ 537 337, 045/ 666 551
Dega në Ferizaj: 0290/ 328 908, 044/ 77 90 90

info@aab-edu.net

www.aab-edu.net

[f /AAB.edu](https://www.facebook.com/AAB.edu)



Niveli parafillor
(grup-mosha 5 - 6 vjeç)
Çmimi 150€ / në muaj

Niveli fillor
(Klasa e parë)
Çmimi 600€ / për gjysmëvjetor

Niveli i mesëm i ulët
(Klasa e gjashtë)
Çmimi 600€ / për gjysmëvjetor

Niveli i mesëm i lartë
(Klasa e dhjetë)

Gjimnazi:
- shkenca natyrore
- shkenca shoqërore
dhe gjuhësore

Çmimi 750€ / për gjysmëvjetor

Afati i
transferit
zgjat deri më
7 janar 2016



038 556 566

045 575 777

britishschoolkosova.com

Magjistranja Prishtinë - Fushë Kosovë

(afër Kolegjit AAB)



INTERNET I SHPEJTË

☎ 0800 10000
www.kosovotelecom.com

n'trip
VALA IME !

2 GB
internet 3G/4G

**500 SMS &
thirrje pa kufi**

2.99€

www.kosovotelecom.com

